

Rezyme

Tema “Poema romantike arbëreshe” (De Rada, Dara, Santori, Skiroi) e përcakton hulumtimin dhe interpretimin e përbërësve kryesorë të veprave të caktuara të letërsisë romantike arbëreshe, duke e trajtuar në mënyrë të veçantë poemën si formë dhe si përmbajtje, me një përqendrim te teoria e formave letrare apo poetika, që njihet nga përkufizimet e studimeve të Zhenetit.

Planifikimi i projektit, zgjedhja e metodave, mbledhja e të dhënave, procesi i hulumtimit, analiza e ligjëritimit, paraqitja e rezultateve, pa dyshim, se i ndërtojnë faktet dhe argumentet e mbështetura në vlerën letrare dhe estetike të poemës romantike arbëreshe.

Hulumtimi shkencor i poemës romantike do të fokusohet në veçoritë kryesore të patrajuara deri më sot përmes mbarështrimit, sistemimit, funksionalizimit të metodologjive bashkëkohore që kanë të bëjnë me tekstologjinë (kritikën e tekstit).

Poema romantike arbëreshe do të hulumtohet përmes leximeve sistematike, mbështetur nga dijet, teoritë, këndvështrimet më cilësore që prodhojnë informacionin e saktë shkencor. Nga dimensionin historiko-letrar synohet të kalohet në dimensionin teoriko-kritik, me një vemëndjesim tek analiza e fenomeneve kryesore që janë të pranishme në poemën romantike arbëreshe.

Për herë të parë në formën e një studimi monografik do të trajtohet poema romantike arbëreshe, në këtë rast, edhe versioni i ri i botimeve të De Radës pas botimeve kritike të vitit 2014. Këto vepra do të interpretohen përbrenda kontekstit të ri kohor, letrar e vlerësues, duke u mbështetur në trajtat, modelet, nocionet, konceptet më të avancuara të mendimit kritik letrar sot.

Hulumtimi i këtyre poemave do të përqendrohet në planin tematik, motivor, strukturor, figurativ, stilistik, gjuhësor etj., me një përqendrim të veçantë mikrostrukturor tek heroi romantik dhe te fenomenet e poemave (ëndrra, vetmia, vdekja etj.)

Fjalët kyçe: Romantizmi, poema romantike arbëreshe, heroi romantik, interpretim letrar, studim monografik, metodologji kërkimore.